



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PRESEDNIKA

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (SZP) NR. 01/2019
PËR VEPRIMET QË NDËRMERREN NË PRESIDENCË PËR
MISIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS JASHTË VENDIT¹**

Prishtinë, 28.01.2019

¹ Neni 11 i Udhëzimit Administrativ (SZP) Nr. 01/2019 për veprimet që ndërmerren në Presidencë për Misionet e Republikës së Kosovës jashtë vendit (28.01.2019) është ndryshuar me Nenin 2 të Udhëzimit Administrativ (SZP) Nr. 03/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (SZP) nr. 01/2019 për veprimet që ndërmerren në Presidencë për Misionet e Republikës së Kosovës jashtë vendit (30.09.2019) dhe këto ndryshime janë të përfshira në Udhëzim Administrativ.



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PRESEDNIKA

Sekretari i Zyrës së Presidentit,

Në mbështetje të nenit 17 (2.7) të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009) dhe nenit 18 të Rregullores (P) Nr. 02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës (08.09.2016), nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (SZP) NR. 01/2019
PËR VEPRIMET QË NDËRMERREN NË PRESIDENCË PËR
MISIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS JASHTË VENDIT

KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky Udhëzim Administrativ përcakton procedurat në Presidencë, për:
 - 1.1. hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e misioneve të Republikës së Kosovës jashtë vendit;
 - 1.2. emërimin, shkarkimin, tërheqjen dhe lirimin nga detyra, të shefave të misioneve diplomatike dhe konsujve të përgjithshëm;
 - 1.3. akreditimin dhe tërheqjen e ambasadorëve.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet nga Departamenti për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, në kuadër të Zyrës së Presidentit dhe njësitë tjera përkatëse në Presidencë, për të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren në Presidencë për:
 - 1.1. hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e misioneve të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. propozimet për emërimin, shkarkimin, tërheqjen dhe lirimin nga detyra, të shefave të misioneve diplomatike dhe konsujve të përgjithshëm;
 - 1.3. akreditimin dhe tërheqjen e ambasadorëve, që përfshijnë lëshimin e letrave kredenciale dhe letrave të tërheqjes.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **President** – Presidenti i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. **Qeveri** – Qeveria e Republikës së Kosovës;
 - 1.3. **Kryeministër** – Kryeministri i Republikës së Kosovës;
 - 1.4. **Ministria (MPJ)** – Ministria e Punëve të Jashtme;
 - 1.5. **Ministër** – Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme;
 - 1.6. **Mision** – Misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës jashtë vendit;
 - 1.7. **Departament** – Departamenti për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Presidentit;
 - 1.8. **Kushtetutë** – Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
 - 1.9. **Ligj** – Ligji Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 26, 02 qershor 2008) dhe Ligji Nr. 03/L-207 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 76, 10 gusht 2010);
 - 1.10. **Ligj për Shërbimin e Jashtëm** – Ligji Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 46, 15 janar 2009).
2. Shprehjet tjera, të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtë si në Kushtetutë, përkufizimet e Ligjit dhe Ligjit për Shërbimin e Jashtëm.

KAPITULLI II – HAPJA, RIORGANIZIMI DHE MBYLLJA E MISIONEVE

Neni 4 Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e misioneve

1. Siç është përcaktuar në Nenin 84 (24) të Kushtetutës, Presidenti vendos për formimin e misioneve, në bazë të konsultimit me Kryeministrin.
2. Presidenti me vetiniciativë apo me propozim të Ministrit mund të merr veprime për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e misioneve.
3. Presidenti para se të vendos për hapjen, riorganizimin apo mbylljen e një misioni, mund të kërkojë që të bëhet një analizë apo arsyetim përkatës.
4. Propozimi i Ministrit për hapjen, riorganizimin apo mbylljen e një misioni, shoqërohet me një analizë apo arsyetim përkatës.
5. Misionet hapen, riorganizohen dhe mbyllet me dekret të Presidentit.

KAPITULLI III – EMËRIMI, SHKARKIMI, TËRHEQJA APO LIRIMI NGA DETYRA I AMBASADORIT, TË NGARKUARIT ME PUNË DHE KONSULLIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 5

Emërimi i ambasadorit nga radhët e anëtarëve në detyrë të shërbimit të jashtëm

1. Departamenti përkujdeset, që propozimi drejtuar Presidentit, për emërimin e Ambasadorit, nga radhët e anëtarëve në detyrë të shërbimit të jashtëm, t'i bashkëngjiten dokumentet, si në vijim:
 - 1.1. shkresa përmes së cilës sigurohet Presidenti, që në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin, kanë përfunduar të gjitha procedurat përkatëse, për kandidatin, që kërkohet të emërohet Ambasador;
 - 1.2. biografia e kandidatit për të cilin kërkohet të emërohet Ambasador;
 - 1.3. kopja e një dokumenti të identifikimit me afat, dhe me fotografi, që duket qartë (Kopja e pasaportës apo e letërnjoftimit); dhe
 - 1.4. dokument tjetër, që konsiderohet i nevojshëm.
2. Emërimi i Ambasadorit, nga radhët e anëtarëve në detyrë të shërbimit të jashtëm, bëhet me dekret nga Presidenti.

Neni 6

Emërimi i ambasadorit nga radhët e personave që nuk janë anëtarë në detyrë të shërbimit të jashtëm

1. Presidenti pranon Raportin e Komisionit përkatës për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për emërimin e Ambasadorit nga radhët e personave, që nuk janë anëtarë në detyrë të shërbimit të jashtëm.
2. Siç përcaktohet në Nenin 7 të Ligjit, Raporti i Komisionit për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës është konsultativ dhe nuk e detyron Presidentin.
3. Nëse Presidenti vendos për emërimin e ambasadorit, Departamenti pas pranimin të raportit, përkujdeset t'i sigurojë dokumentet, si në vijim:
 - 3.1. biografinë e kandidatit për të cilin kërkohet të emërohet Ambasador, nëse Raporti nuk e përmban një të tillë;
 - 3.2. kopja e një dokumenti të identifikimit me afat, dhe me fotografi, që duket qartë (Kopja e pasaportës apo e letërnjoftimit); dhe
 - 3.3. dokument tjetër, që konsiderohet i nevojshëm.
4. Emërimi i Ambasadorit, nga radhët e personave, që nuk janë anëtarë në detyrë të shërbimit të jashtëm, bëhet me dekret nga Presidenti.

Neni 7

Emërimi i të ngarkuarit me punë

1. Departamenti përkujdeset, që propozimi drejtuar Presidentit, për emërimin e të ngarkuarit me punë në një mision, t'i bashkëngjiten dokumentet, si në vijim:
 - 1.1. shkresa përmes së cilës sigurohet Presidenti, që në pajtim me Kushtetutën, Ligjin, dhe Ligjin për Shërbimin e Jashtëm, kanë përfunduar të gjitha procedurat përkatëse, për kandidatin që kërkohet të emërohet i ngarkuar me punë.
 - 1.2. biografia e kandidatit për të cilin kërkohet të emërohet i ngarkuar me punë;
 - 1.3. kopja e një dokumenti të identifikimit me afat, dhe me fotografi, që duket qartë (Kopja e pasaportës apo e letërnjoftimit); dhe

- 1.4. dokument tjetër, që konsiderohet i nevojshëm.
2. Emërimi i të ngarkuarit me punë në një mision bëhet me dekret nga Presidenti.

Neni 8

Emërimi i ambasadorit jo rezidentë

1. Departamenti, përkujdeset, që propozimi drejtuar Presidentit, për emërimin e Ambasadorit jo rezidentë, t'i bashkëngjiten dokumentet, si në vijim:
 - 1.1. shkresa përmes së cilës sigurohet Presidenti, që në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Ligjin për Shërbimin e Jashtëm, kanë përfunduar të gjitha procedurat përkatëse, për kandidatin, që kërkohet të emërohet Ambasador jo rezidentë;
 - 1.2. biografia e kandidatit për të cilin kërkohet të emërohet Ambasador jo rezidentë;
 - 1.3. kopja e një dokumenti të identifikimit me afat, dhe me fotografi, që duket qartë (Kopja e pasaportës apo e letërnjoftimit); dhe
 - 1.4. dokument tjetër, që konsiderohet i nevojshëm.
2. Emërimi i Ambasadorit jo rezidentë, në një shtet ku nuk ka mision, bëhet me dekret nga Presidenti.

Neni 9

Emërimi i Konsullit të Përgjithshëm

1. Departamenti përkujdeset, që propozimi drejtuar Presidentit, për emërimin e Konsullit të Përgjithshëm, t'i bashkëngjiten dokumentet, si në vijim:
 - 1.1. Shkresa, përmes së cilës sigurohet Presidenti, që në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin, kanë përfunduar të gjitha procedurat brenda MPJ - së, për kandidatin, që kërkohet të emërohet Konsull i Përgjithshëm;
 - 1.2. biografia e kandidatit për të cilin kërkohet të emërohet Konsull i Përgjithshëm;
 - 1.3. kopja e një dokumenti të identifikimit me afat, dhe me fotografi, që duket qartë (Kopja e pasaportës apo e letërnjoftimit); dhe
 - 1.4. dokument tjetër, që konsiderohet i nevojshëm.
2. Emërimi i Konsullit të Përgjithshëm bëhet me Dekret nga Presidenti.

Neni 10

Shkarkimi i Ambasadorit, të Ngarkuarit me Punë apo Konsullit të Përgjithshëm

1. Departamenti përkujdeset, që propozimi drejtuar Presidentit, për shkarkimin e Ambasadorit, të Ngarkuarit me Punë apo Konsullit të Përgjithshëm, t'i bashkëngjiten dokumentet, si në vijim:
 - 1.1. shkresa përmes së cilës sigurohet Presidenti, që në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Ligjin për Shërbimin e Jashtëm, kanë përfunduar të gjitha procedurat brenda Qeverisë, për shkarkimin e Ambasadorit, të Ngarkuarit me Punë apo Konsullit të Përgjithshëm, që kërkohet të shkarkohet;
 - 1.2. arsyetimin përkatës.
2. Shkarkimi i Ambasadorit, të Ngarkuarit me Punë apo Konsullit të Përgjithshëm nga misioni, bëhet me dekret nga Presidenti.

Neni 11
Tërheqja nga misioni i Ambasadorit, të Ngarkuarit me Punë apo Konsullit të Përgjithshëm

1. Presidenti i Republikës së Kosovës me Dekret urdhëron tërheqjen e Ambasadorit, të Ngarkuarit me Punë apo Konsullit të Përgjithshëm nga misioni, përpara mbarimit të afatit të caktuar, për arsyt e përcaktuara në nenin 23 (1) të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm.
2. Departamenti përgatit propozim dekretin dhe/apo shqyrton shkresat dhe raportet përkatëse.

Neni 12
Lirimi nga detyra e Ambasadorit, të Ngarkuarit me Punë dhe Konsullit të Përgjithshëm

1. Departamenti përkujdeset, që propozimi drejtuar Presidentit, për lirimin nga detyra të Ambasadorit, të Ngarkuarit me Punë apo Konsullit të Përgjithshëm nga misioni, t'i bashkëngjiten dokumentet, si në vijim:
 - 1.1. Shkresa, përmes së cilës sigurohet Presidenti, që në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Ligjin për Shërbimin e Jashtëm, kanë përfunduar të gjitha procedurat brenda Ministrisë dhe mund të bëhet lirimi nga detyra i Ambasadorit, të Ngarkuarit me Punë apo Konsullit të Përgjithshëm;
 - 1.2. informata se ka përfunduar mandati i Ambasadorit, të Ngarkuarit me Punë apo Konsullit të Përgjithshëm, për të cilin propozohet lirimi nga detyra.
2. Presidenti me dekret bënë lirimin nga detyra të Ambasadorit, të Ngarkuarit me Punë apo Konsullit të Përgjithshëm.

KAPITULLI IV – AKREDITIMI DHE TËRHEQJA E AMBASADORIT

Neni 13
Akreditimi i Ambasadorit

1. Departamenti përkujdeset, që kërkesës drejtuar Presidentit, për akreditimin, përkatësisht lëshimin e letrave kredenciale, për kandidatin e emëruar për ambasador për në shtetin pranues, t'i bashkëngjiten dokumentet, si në vijim:
 - 1.1. shkresa, përmes së cilës sigurohet Presidenti, që në pajtim me Kushtetutën, Ligjin, Ligjin për Shërbimin e Jashtëm dhe Konventën për Marrëdhënie Diplomatike (1961), është pranuar pëlqimi nga shteti pranues dhe mund të procedohet tutje me lëshimin e Letrave Kredenciale;
 - 1.2. pëlqimi i shteti pranues;
 - 1.3. njoftimi se kujt duhet t'i adresohen letrat kredenciale, duke përfshirë edhe pozitën e saktë të të adresuarit në shtetin pranues.
2. Presidenti lëshon letrat kredenciale për akreditimin e kandidatit të emëruar për Ambasador në shtetin pranues.

Neni 14
Tërheqja e Ambasadorit

1. Departamenti përkujdeset, që kërkesa drejtuar Presidentit, për lëshimin e letrave të tërheqjes për Ambasadorin e shkarkuar, tërhequr përpara mbarimit të mandatit apo të liruarit nga detyra për shkak të përfundimit të mandatit, t'i bashkëngjiten dokumentet, si në vijim:
 - 1.1. shkresa, përmes së cilës sigurohet Presidenti, që në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Ligjin për Shërbimin e Jashtëm, mund të procedohet tutje me lëshimin e letrave për tërheqje;
 - 1.2. informata lidhur me Ambasadorin, për të cilin kërkohet të lëshohen letrat e tërheqjes;
 - 1.3. njoftimi se kujt duhet t'i adresohen letrat e tërheqjes, duke përfshirë edhe pozitën e saktë të të adresuarit në shtetin pranues.
2. Presidenti lëshon letrat e tërheqjes për tërheqjen e Ambasadorit nga misioni.

KAPITULLI V - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Rregullorja Nr. 006/2016 mbi Rregullat e Procedurës në procesin e emërimit të Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve Diplomatike (24.03.2016).

Neni 16
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Driton GASHI

Sekretar i Zyrës së Presidentit

Prishtinë, 28.01.2019